



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 7 prill 2016  
Nr. ref.:RK917/16

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI45/15**

Parashtrues

**Elizabeta Arifi-Deliu**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,  
ARJ-UZVP. nr. 13/2014, të 30 shtatorit 2014**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare,  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Elizabeta Arifi-Deliu (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), me banim në Prishtinë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP. nr. 13/2014, i 30 shtatorit 2014, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e parashtrueses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (AA. nr. 1/2014, të 25 marsit 2014).
3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 22 dhjetor 2014.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon që i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit (A. nr. 02/175/2012, të 27 korrikut 2012) të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPM) dhe vlerësimin e kushtetutshmërisë së *“Renditjes përfundimtare të kandidatëve (30 kandidatët e parë) të 20 prillit 2012, në Policinë e Kosovës, duke pasur parasysh përbërjen e Komisionit Përzgjedhës”*.

## **Baza juridike**

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 17 prill 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 2 qershor 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI45/15, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI45/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.
9. Më 10 qershor 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe KPM-së.
10. Më 10 qershor 2015, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojë fletëkthesën, e cila tregon se kur parashtrueses së kërkesës i ishte

dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, ARJ-UZVP. nr. 13/2014, të 30 shtatorit 2014.

11. Më 29 qershor 2015, Gjykata e pranoi fletëkthesën e kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë që tregon se parashtrueses së kërkesës i ishte dorëzuar Aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës Supreme më 22 dhjetor 2014.
12. Më 1 korrik 2015, me Vendimin nr. KSH. KI45/15 për zëvendësimin e gjyqtarit raportues, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese.
13. Më 8 mars 2016, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

14. Më 15 dhjetor 2011, Policia e Kosovës i shpalli 30 (tridhjetë) vende të lira të punës për pozitën e Asistentit administrativ, për të cilën pozitë kishte aplikuar parashtruesja e kërkesës.
15. Pas përfundimit të të gjitha procedurave të testimit, parashtruesja ishte njoftuar se ajo nuk ishte në listën e 30 (tridhjetë) kandidatëve të përzgjedhur për pozitën e Asistentit administrativ.
16. Më 3 maj 2012, parashtruesja ushtroi ankesë te Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit të Policisë së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit), për shkak të mospërfshirjes në listë.
17. Më 18 qershor 2012, Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit e njoftoi parashtruesen se ankesa e saj është refuzuar, si e pabazuar.
18. Më 6 korrik 2012, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në KPM kundër vendimit të Njesisë së Rekrutimit dhe Seleksionimit.
19. Në ankesën e saj, parashtruesja pretendoi se gjatë procesit përfundimtar të përzgjedhjes, komisioni i krijuar për përzgjedhjen e kandidatëve kishte shkelur dispozitat e legjislacionit në fuqi në lidhje me rekrutimin e shërbimit civil.
20. Më 27 korrik 2012, KPM-ja (Vendimi, A. nr. 02/175/2012) e refuzoi ankesën e parashtrueses, si të pabazuar.
21. KPM-ja konkludoi, pas shqyrtimit të të gjitha provave të paraqitura nga palët, që procedurat e rekrutimit dhe përzgjedhja përfundimtare e kandidatëve ishin kryer në përputhje me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.
22. Më 7 shtator 2012, parashtruesja parashtrroi padi në Gjykatën Supreme të Kosovës. Në padinë e saj, parashtruesja pretendoi se Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit veproi duke shkelur Ligjin e Shërbimit Civil të Kosovës, Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe se gjatë procedurës së rekrutimit ajo ishte diskriminuar.

23. Padia e parashtrueses i ishte referuar Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje administrative (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) pas hyrjes në fuqi të Ligjit për gjykatat (1 janar 2013), si organ kompetent në procedurën administrative për të adresuar pretendimin e parashtrueses u bë Gjykata Themelore në vend të Gjykatës Supreme.
24. Më 1 korrik 2013, Gjykata Themelore (Aktvendimi, A. nr. 1032/12, të 1 korrikut 2013) kërkoi nga parashtruesja e kërkesës prova shtesë.
25. Më 9 korrik 2013, parashtruesja dorëzoi në Gjykatën Themelore plotësimin e kërkuar dhe kërkoi anulimin e Vendimit të KPM-së (A. nr. 02/175/2012) dhe kompensimin e dëmit për shkak të parandalimit të punësimit.
26. Më 10 tetor 2013, Gjykata Themelore (Aktgjykimi A. nr. 1032/2012) e refuzoi kërkesën e parashtrueses, si të pabazuar.
27. Pas shqyrtimit të provave të paraqitura, Gjykata Themelore ka gjetur se KPM-ja ka konstatuar drejt gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të drejtës materiale. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Themelore konstatoi më tej se duke u bazuar në vlerësimin e Gjykatës, Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit ka vepruar në pajtim me ligjin dhe i ka renditur ata kandidatë që i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret për pozitën e shpallur.
28. Më 27 nëntor 2013, parashtruesja ushtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (A. nr. 1032/2012, të 10 tetorit 2013) duke pretenduar shkelje të së drejtës materiale, vlerësim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave procedurale.
29. Më 25 mars 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi AA. nr. 1/2014) e refuzoi ankesën e parashtrueses si të pabazuar dhe në këtë mënyrë e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
30. Pas vlerësimit të aktgjykimit të kontestuar dhe administrimit të provave, Gjykata e Apelit e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Gjykata e Apelit e Kosovës konstatoi më tej se e aprovoi në tërësi qëndrimin e drejtë dhe të bazuar ligjërisht të gjykatës së shkallës së parë, sepse aktgjykimi i kontestuar nuk është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e së drejtës materiale apo dispozitat procedurale.
31. Sa i përket pretendimit të parashtrueses së kërkesës në lidhje me vlerësimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit konstatoi se gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat e paraqitura dëshmoi se KPM-ja nuk ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil.
32. Më 6 maj 2014, parashtruesja parashtrroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ajo kërkoi rishqyrtimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës (AA. nr. 1/2014, të 25 marsit 2014) duke pretenduar shkelje të së drejtës materiale, konstatim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të dispozitave procedurale.

33. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendoi se gjatë procedurës së rekrutimit ajo ishte diskriminuar.
34. Më 30 shtator 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (ARJ-UZVP. nr. 13/2014), refuzoi kërkesën e parashtrueses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, si të pabazuar.
35. Gjykata Supreme gjeti se gjykatat e shkallës më të ulët vendosën në mënyrë të drejtë duke refuzuar kërkesën e parashtrueses për anulimin e vendimit të KPM-së (A. nr. 02/175/2012).
36. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj konsideroi se *“rekrutimi sipas konkursit të publikuar nga Ministria e Brendshme për pozitën Asistent administrativ është bërë në pajtim me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil nenin 2 paragrafin 1, nënparagrafin 1.3 - parimin e meritës dhe procedurave të rekrutimit në pajtim me Rregulloren nr. 02/2010 mbi procedurën e rekrutimit. Me nenin 11.1. dhe nenin 18.1 parashihet se pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues dhe mosdiskriminimin e kandidatëve dhe përfaqësimit të barabartë. Ankuesja është renditur e 49 (dyzetenëta) me 71.15% të pikëve, ndërsa janë përzgjedhur kandidatët që kanë realizuar prej 71.95% deri 77.95%, duke e përzgjedhur kandidatët të cilët kanë plotësuar kushtet e kërkuara”*.
37. Gjykata Supreme konstatoi se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit ishte i qartë dhe i kuptueshëm, dhe se ai përmbante arsye të mjaftueshme dhe fakte vendimtare për nxjerrjen e vendimeve të ligjshme.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

38. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Policia e Kosovës, KPM-ja dhe gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 7 [Vlerat], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]. Parashtruesja, më tej, pretendon se këto autoritete publike kishin shkelur të drejtat e saj të garantuara me KEDNJ sipas nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenit 14 [Ndalimi i diskriminimit].
39. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës nga gjykatat e rregullta, parashtruesja saktëson se *“Gjykata Supreme nuk ka nxjerrë një vendim të arsyetuar që të më demonstrojë si palë ankuese se jam dëgjuar lidhur me ankesat e mia [...]”*. Prandaj, parashtruesja e kërkesës pretendon se *“Me aktgjykimet e gjykatave të rregullta pretendoj se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] e KEDNJ”*.
40. Sa i përket pretendimeve të saj për diskriminim, parashtruesja pohon *“jam ankuar edhe për diskriminim si grua shtatzënë përshkruar në nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] i KEDNJ në bazë të ndonjë statusi tjetër personal. Punësimi është bërë në qershor 2012, unë kam lindur fëmijën më 28.07.2012. Gjykatat e rregullta do të duhej ta trajtonin në mënyrë specifike se pse kur*

*kam dalur fizikisht para komisionit kam marrë më pak pikë se në test me shkrim për dallim prej kandidatëve tjerë”.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

41. Në mënyrë që të jetë në gjendje ta gjykojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe me Rregullore të punës.
42. Gjykata vëren se parashtruesja është palë e autorizuar në bazë të Kushtetutës, ajo e konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, se i ka shteruar mjetet e nevojshme juridike dhe se ka paraqitur kërkesën e saj brenda periudhës kohore prej 4 (katër) muajsh pas marrjes së aktgjykimit.
43. Parashtruesja e kërkesës i ka deklaruar në mënyrë të qartë të drejtat dhe liritë kushtetuese që pretendohen të jenë shkelur dhe vendimin e kontestuar siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

44. Përveç kësaj, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesja e kishte plotësuar rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*(2) “Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*

*(b) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*

*(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose*

*(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

45. Gjykata vëren se përveç kërkesës së parashtrueses për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, parashtruesja në kërkesën e saj gjithashtu kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të KPM-së dhe vendimit për *“Renditjen përfundimtare të kandidatëve (30 kandidatët e parë) të 20 prillit 2012, në Polici të Kosovës, duke pasur parasysh përbërjen e Komisionit Përzgjedhës”*. Në këtë drejtim, ajo pretendon shkelje të nenit 24 dhe të nenit 31 të Kushtetutës.
46. Gjykata vëren se parashtruesja ngriti të njëjtat pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e Ligjit për Shërbimin Civil, Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe se ajo ishte diskriminuar gjatë procedurës administrative nga

gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë. Pretendimet e saj ishin adresuar nga gjykatat përkatëse dhe ishin arsyetuar si duhet.

47. Në kërkesën e saj për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme, ajo pretendoi shkelje të drejtës materiale dhe procedurale, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe se gjatë procedurës së rekrutimit ajo ishte diskriminuar. Prandaj, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme adresoi dhe vendosi për pretendimet e lartpërmendura, të cilat tanimë ishin ngritur në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë. Për këtë arsye, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është tani vendimi përfundimtar për këtë objekt çështjeje kontestuese.
48. Në lidhje me pretendimet e parashtrueses se ajo ishte diskriminuar, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit konstatuan se procedura e rekrutimit ishte mbajtur në përputhje me parimet e Shërbimit Civil të përcaktuara në Ligjin për Shërbimin Civil. Për më tepër, Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj konfirmoi se procedura e rekrutimit është kryer në pajtim me ligjin në fuqi dhe se ajo ishte bazuar në *“parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësi të komisionit testues dhe mosdiskriminimit të kandidatëve dhe përfaqësimit të barabartë”*.
49. Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka paraqitur fakte dhe nuk e ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e saj për diskriminim. Kur pretendohet një shkelje e tillë kushtetuese, parashtruesja e kërkesës duhet të paraqesë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës.
50. Sa i përket pretendimeve të parashtrueses së kërkesës se gjykatat e rregullta nuk kanë nxjerrë vendime të arsyetuara, Gjykata i referohet vendimit përfundimtar të Gjykatës Supreme e cila në aktgjykimin e saj konkludoi se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit ishte i qartë dhe i kuptueshëm, dhe se ai përmbante arsye të mjaftueshme dhe fakte vendimtare për nxjerrjen e vendimit të ligjshëm.
51. Përveç kësaj, ajo gjithashtu pretendon, se Gjykata Supreme nuk nxori një vendim të arsyetuar *“i cili do të tregonte për mua si një palë që ankohet që unë jam dëgjuar në lidhje me ankesat e mia [...]”*, duke e shkelur në këtë mënyrë nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
52. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesja nuk e ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e saj për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Për më tepër, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj i adresoi çështjet thelbësore të ngritura në kërkesën e parashtrueses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet edhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas së cilës neni 6 nuk kërkon një përgjigje të detajuar për çdo argument që i ofrohet gjykatës gjatë mbajtjes së procedurës (Shih, *Van de Hurk kundër Holandës*, Nr. 16034/90, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 prillit 1994, para. 61).
53. Prandaj, Gjykata konstaton se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata ka gjetur se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo

arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

54. Si përfundim, Gjykata thekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
55. Gjykata përfundon se faktet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave të saj kushtetuese dhe se parashtruesja nuk e ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e saj.
56. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2), b) dhe d) të Rregullores së punës, më 8 mars 2016, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova

Arta Rama-Hajrizi

